

Broshurë informative

Mbrojtja ndërkombëtare në Belgjikë



Albanian

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| 1. Mbrojtja ndërkombëtare në Belgjikë | 4 |
| 2. Kur kërkohet mbrojtja ndërkombëtare? | 5 |
| 3. Disa nocione të rëndësishme | 6 |
| 3.1 Çfarë është një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare ? | 6 |
| 3.2 Kush quhet "një kërkuar i mbrojtjes ndërkombëtare" ? | 7 |
| 3.3 Çfarë është Dublini ? | 7 |
| 3.4 Çfarë do të thotë "vendim definitiv" ? | 7 |
| 3.5 Kur bëhet fjalë për "kërkesë e mëvonëshme për mbrojtje ndërkombëtare" ? | 7 |
| 3.6 Çfarë nënkuptohet me "të dhënat biometrike" ? | 8 |
| 4. Qasja në procedurë | 8 |
| 4.1 Ku kërkohet mbrojtja ndërkombëtare ? | 8 |
| 4.2 Kur fillon procedura ? | 8 |
| 4.2.1 Paraqitja dhe regjistrimi i kërkesës | 9 |
| 4.2.2 Dorëzimi i Kërkesës | 13 |
| 5. A do të merren parasysh nevojat e mia specifike ? | 16 |
| 6. Dublini? | 17 |
| 6.1 Kur zbatohet Dublini ? | 18 |
| 6.2 A mund të transferohem me forcë drejt shtetit anëtarë përgjegjës? | 18 |
| 7. A do të dëgjohem nga oe ? | 19 |
| 7.1 Cili është roli i bashkëpunëtorit dhe i përkthyesit ? | 19 |
| 7.2 Cili është qëllimi i dëgjimit ? | 20 |
| 7.3 Mbyllja e dëgjimit | 21 |
| 7.4 Detyrimi për të bashkëpunuar | 21 |
| 7.5 Si do të organizohet dëgjimi ? | 22 |
| 8. Cilat dokumente do ju lëshohen ? | 23 |
| 8.1 Gjatë procedurës | 23 |
| 8.2 Pas dhënies së statusit të refugjatit | 24 |
| 8.3 Pas dhënies së statusit të mbrojtjes plotësuese | 24 |
| 8.4 Pas refuzimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare | 25 |
| 9. A mund të modifikojë të dhënat e identitetit tim ? | 26 |
| 10. Jam i mitur dhe i pa shoqëruar... çfarë duhet të bëj ? | 26 |
| 11. A mund të ndihmohem nga një avokat gjatë procedurës ? | 28 |
| 12. Si të kthehem në vendin tim të origjinës ? | 29 |
| 13. A mund të mbahem gjatë procedurës ? | 30 |
| 14. Çfarë bën OE me të dhënat e mia me karakter personal | 30 |
| 15. Adresat e dobishme | 31 |

1. Mbrojtja ndërkombëtare në Belgjikë

Çdo i huaj që ndodhet në territorin belg mund të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë nga autoritetet kompetente belge.

Në këtë proces janë të përfshirë disa organe:



Zyra e të Huajve (OE)

Zyra e të Huajve është organi kompetent në lidhje me hyrjen në territor, qëndrimin, vendosjen dhe largimin e të huajve në Belgjikë.

Zyra e të Huajve regjistron aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare dhe përcakton nëse Belgjika – ose një shtet tjetër anëtar – është përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit.

<https://dofi.ibz.be/>



Komisariati i Përgjithshëm i Refugjatëve dhe personave Pashtetësi (CGRA)

CGRA është organi kompetent për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. CGRA do të vlerësojë nevojën për mbrojtje.

<https://www.cgra.be/>



Këshilli Kontestues për të Huajt (CCE)

CCE-ja është një juridiksion administrativ.

Nëse një i huaj nuk pajtohet me një vendim të marrë nga Zyra e të Huajve (OE) ose CGRA, ai mund të bëjë ankesë kundër këtij vendimi në CCE.

CCE-ja merr vendim për këtë ankesë. CCE-ja gjithashtu ka kompetencë me juridiksion të plotë për të dhënë statusin (refugjat ose mbrojtje shtesë).

CCE-ja gjithashtu mund të vendosë të rikthejë dosjen në OE ose CGRA nëse është i nevojshëm një hetim shtesë.

<https://www.rvv-cce.be/>



Këshilli i Shtetit (CE)

CE është një juridiksion ku mund të bëhet ankim kundër një vendimi të CCE-së.

<https://www.conseildetat.be/>



Agjencia Federale për Strehim të Kërkuesve të Azilit (Fedasil)

Fedasil ofron strehim për kërkuesit e mbrojtjes ndërkombëtare. Fedasil gjithashtu mbikëqyr kontrollin mjekësor të të gjithë kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare. Përveç kësaj, Agjencia ofron mbështetje në kontekstin e kthimeve vullnetare në vendin e origjinës.

<https://www.fedasil.be/>

2. Kur kërkohet mbrojtja ndërkombëtare?

Ju mund të kërkoni mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë nëse rrezikoni të persekutoheni ose të dëmtoheni rëndë nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës.

Së pari duhet të përcaktohet se cili shtet anëtar është përgjegjës për trajtimin e kërkesës suaj.

Nëse Belgjika është përgjegjëse për trajtimin e kërkesës suaj, CGRA së pari shqyrton nëse mund të kërkoni statusin e refugjatit. Nëse jo, ai verifikon nëse mund të merrni statusin e mbrojtjes plotësuese.

Për më shumë informata në lidhje me Dublinin në pikën 6. Dublin

STATUSI I REFUGJATIT

Mund t'ju jepet statusi i refugjatit nëse keni frikë nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, bindjeve politike ose i takoni një grupi të caktuar shoqëror DHE nëse nuk mund të mbështeteni në mbrojtjen e autoriteteve tuaja.

Këto kritere u përcaktuan në Konventën e Gjenevës të 28 korrikut 1951 (e quajtur edhe “Konventa e Refugjatëve”).



STATUSI I MBROJTJES PLOTËSUESE

Nëse nuk i plotësoni kushtet si refugjat, por sërish rrezikoni të pësoni dëmtime të rënda nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës, mund t'ju jepet statusi i mbrojtjes plotësuese.

Dëmtim i rëndë do të thotë :

- dënimin me vdekje ose ekzekutimin; ose
- tortura ose trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose poshtëruës që i bëhet një kërkuesi në vendin e tij të origjinës; ose
- kërcënime serioze ndaj jetës ose personit të një civili për shkak të dhunës pa dallim në rast të një konflikti të armatosur të brendshëm ose ndërkombëtar.

3. Disa nocione të rëndësishme

3.1 ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE ?

Kur kërkoni mbrojtje nga autoritetet belge për shkak të rrezikut të persekutimit ose dëmtimit të rëndë në rast të kthimit në vendin tuaj të origjinës, ju paraqisni një “kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare”.

3.2 KUSH QUHET ‘NJË KËRKUES I MBROJTJES NDËRKOMBËTARE’ ?

Nëse keni dorëzuar një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare pranë autoriteteve kompetente belge, ju jeni një “*kërkues për mbrojtje ndërkombëtare*” derisa të merret një vendim përfundimtar për kërkesën tuaj.

3.3 ÇFARË ËSHTË DUBLINI ?

Për më shumë informata në lidhje me Dublinin në pikën 6. Dublin

Në Evropë, ju nuk mund të zgjidhni lirisht vendin nga i cili dëshironi të merrni mbrojtje ndërkombëtare. Këto rregulla janë të përfshira në Rregulloren e Dublinit e cila përcakton se cili “shtet i Dublinit” duhet të trajtojë kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Pasi të keni dorëzuar një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë, Zyra e të Huajve shqyrton nëse Belgjika ose një “shtet tjetër i Dublinit” duhet të trajtojë kërkesën tuaj.

3.4 ÇFARË DO TË THOTË “VENDIM DEFINITIV” ?

Kur është marrë një vendim për kërkesën tuaj (*d.m.th. nëse do të jepet apo jo statusi i mbrojtjes*) dhe që asnjë ankesë e mëtejshme nuk është e mundur kundër këtij vendimi (*siç parashikohet nga Ligji për të huajt*), atëherë ky është një “*vendim përfundimtar*”.

3.5 KUR BËHET FJALË PËR “KËRKESË E MËVONËSHME PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE” ?

Bëhet fjalë për një “*kërkesë të mëvonshme për mbrojtje ndërkombëtare*” kur ju keni paraqitur tashmë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë për të cilën është marrë një vendim përfundimtar DHE më pas keni paraqitur një kërkesë të re”.

Çdo kërkesë pasuese – e paraqitur pasi është marrë një vendim përfundimtar për kërkesën e mëparëshme – konsiderohet një “**kërkesë e mëvonëshme**”.

3.6 ÇFARË NËNKUPTOHET ME “TË DHËNAT BIOMETRIKE” ?

Për çdo kërkues të mbrojtjes ndërkombëtare, mbliidhen “të dhëna biometrike”: këto janë shenjat e gishtërinjve dhe imazhi i fytyrës (*Iloji i fotografisë*).

Këto mund të përdoren për të kryer një krahasim (*automatik*) biometrik.

4. Qasja në procedurë

4.1 KU KËRKOHET MBROJTJA NDËRKOMBËTARE ?

Nëse dëshironi të aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë, duhet të paraqiteni **sa më shpejt të jetë e mundur** DHE **personalisht** në Zyrën e të Huajve

Është gjithashtu e mundur të aplikoni për mbrojtje:

- Në **kufi** te autoritetet përgjegjëse për kontrollin e kufirit
- Në një **qendër të mbyllur**, me zyrtarë të zyrtarët e Zyrës së të Huajve
- Në **burg**, me drejtorin e burgut

4.2 KUR FILLON PROCEDURA ?

Procedura nuk fillon menjëherë. Ka disa faza të ndryshme paraprake.

- Paraqitja e kërkesës
- Regjistrimi i kërkesës
- Dorëzimi i kërkesës

Prania **juaj personale** është e nevojshme në secilën nga këto tre faza.

4.2.1 Paraqitja dhe regjistrimi I kërkesës

Nëse jeni në territorin belg dhe dëshironi të kërkonit mbrojtje ndërkombëtare, duhet të shkoni në Zyrën e të Huajve. Aty, ju mund të paraqisni kërkesën tuaj.

OE regjistron nëse është e mundur – kërkesën tuaj në të njëjtën ditë.

Me rastin e regjistrimit të kërkesës suaj, ju informoheni për procedurën që duhet ndjekur për të dorëzuar kërkesën. Procedura fillon vetëm kur të keni dorëzuar efektivisht kërkesën.

Nëse kërkesa nuk mund të dorëzohet në të njëjtën ditë, ju do të merrni një vërtetim të lajmërimit. Ky dokument dëshmon se ju keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Nga ky moment, konsideroheni kërkuar për mbrojtje ndërkombëtare.

Regjistrimi përbëhet nga :



Përcaktimi i identitetit

Në momentin e regjistrimit, OE përcakton identitetin tuaj (*mbiemri, emri, data e lindjes, vendlindja, kombësia*), mundësisht në bazë të dokumenteve të identitetit që posedoni. Nëse nuk keni dokumente identiteti, të dhënat shënohen në bazë të deklaratave tuaja.

Nëse keni **dokumente origjinale të identitetit** ose një **kopje të këtyre dokumenteve**, është thelbësore t'i sillni ato me vehte në OE.



Marrja e informatave tjera të rëndësishme

Për të përfunduar regjistrimin, OE kontrollon se sa kohë keni qenë në Belgjikë, nëse keni tashmë një adresë banimi dhe nëse keni nevojë për strehim.

OE ju pyet gjithashtu nëse dëshironi të ndihmoheni nga një përkthyes gjatë procedurës.

Identifikimi i ndonjë ndjeshmërie eventuale të kërkuesit



Në momentin e regjistrimit, bëhen pyetje edhe për ndjeshmëritë tuaja të mundshme. Në kuadër të strehimit dhe pjesës tjetër të procedurës, është e rëndësishme të specifikoni nëse keni disa ndjeshmëri që duhet të merren parasysh.

Informimi i kërkuesit me të drejtat dhe obligimet e tij



Si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, ju keni një sërë të drejtash por edhe disa detyrime.

Kështu, ju keni të **drejtën e strehimit** dhe mund të merrni **ndihmë materiale** nga Fedasil. Si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, ju jeni gjithashtu të mbrojtur kundër **kthimit**. Kjo do të thotë që në parim nuk mund të ktheheni në vendin tuaj të origjinës gjatë procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare, përveç rasteve të parashikuara nga Ligji për të huajt.

Për më tepër, autoritetet belge nuk u lejohet, në asnjë moment gjatë procedurës, të kontaktojnë ose të ndajnë informacion me autoritetet e vendit tuaj të origjinës.

Kujdes : e drejta për strehim mund të jetë e kufizuar.

Si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, gjithashtu pritet nga ju që gjithmonë të thoni të vërtetën dhe të **bashkëpunoni plotësisht** gjatë procedurës.

Nëse keni **dokumente identiteti**, ju **kërkohet** t'i paraqisni ato sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë regjistrimit të kërkesës suaj.

Gjithashtu ju **kërkohet** të paraqisni sa më shpejt të jetë e mundur çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë autoritetet kompetente të përcaktojnë shtetin anëtar përgjegjës për trajtimin e kërkesës suaj.

Fshehja e dokumenteve ose refuzimi për të paraqitur dokumente të caktuara mund të tregojë mungesë bashkëpunimi.

Mungesa e bashkëpunimit mund të çojë në mbajtjen tuaj në një vend të caktuar gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj ose do të çojë në trajtim të pëshpejtuar të kërkesës suaj nga CGRA. Në rast se Belgjika është përgjegjëse për trajtimin e kërkesës.



Ju do të informoheni për të drejtat dhe detyrimet tuaja gjatë regjistrimit të kërkesës suaj.

Cilat janë dokumentet e rëndësishme ?

Të gjitha dokumentet në lidhje me moshën tuaj, të kaluarën (*përfshirë atë të anëtarëve përkatës të familjes*), identitetin, kombësinë, shtetin(et) dhe vendndodhjen(et) e vendbanimit(eve) të mëparshme, informacionin mbi kërkesat e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare, udhëtimin tuaj, dokumentet tuaja të identitetit, etj., si dhe çdo dokument tjetër që tregon problemet e hasura në vendin e origjinës.



Marrja e të dhënave biometrike

Kur regjistroni kërkesën tuaj, një punonjës i OE merr fotografinë tuaj dhe merr shenjat e gishtave. Marrja e shenjave të gishtave i lejon Zyrës së të Huajve të kontrollojë nëse jeni të njohur në Zyrën e të Huajve ose në një Shtet tjetër Anëtar që zbaton Rregulloren a ashtuquajtur “Dublin”.

Fotoja juaj është e bashkangjitur në dosjen tuaj administrative dhe është ngjitur në dokumente të ndryshme që merrni nga OE si pjesë e procedurës që ka të bëjë me ju.



Ju mund të gjeni më shumë informata lidhur me regjistrimin e një kërkesë ne faqen internet të Zyrës së të Huajve :

<https://tinyurl.com/dpipresentationENG>



Të dhënat :

Office des étrangers (OE)
Département Protection internationale

e-mail : registration@ibz.fgov.be

4.2.2 Dorëzimi I Kërkesës

Në ditën e regjistrimit ose më së voni brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës tuaj, ju keni mundësinë të dorëzoni kërkesën tuaj.

Gjatë dorëzimit të një kërkesë, një numër i caktuar i kushteve ligjore duhet të respektohen :



Zgjedhja e vendbanimit në Belgjikë

Të gjithë kërkuesve u kërkohet të zgjedhin vendbanimin në Belgjikë. OE ju pyet se ku keni zgjedhur për të banuar. Kjo mund të jetë adresa ku jetoni në të vërtetë, por gjithashtu mund të zgjidhni vendbanimin te avokati juaj, te miqtë, te familja juaj, etj. në Belgjikë.

Zyra e të Huajve dhe CGRA dërgojnë të gjithë korrespondencën në lidhje me procedurën tuaj (*d.m.th. ftesat, kërkesat për informacion, vendimet, etj.*) në këtë adresë.

Nëse nuk zgjidhni një vendbanim, adresa e CGRA-së konsiderohet vendbanimi juaj i zgjedhur dhe e gjithë korrespondenca dërgohet në këtë adresë.



Ky formular i është bashkëngjitur kësaj broshurë shtojcën 1 dhe gjendet gjithashtu në faqen internet të OE :

<https://tinyurl.com/dpiformsENG>



Në këtë rast, duhet të shkoni gjithmonë në CGRA për të marrë korrespondencën tuaj.

Është **ligjërishme e detyrueshme** të informoni Zyrën e të Huajve dhe CGRA për çdo ndryshim adrese.

Për këtë është dhënë një formularë i veçantë. Duhet të plotësohet dhe të dërgohet me postë të rekomanduar në OE dhe CGRA.



Kujdes :Nëse ndryshoni adresën tuaj dhe nuk njoftoni fare OE ose CGRA ose i njoftoni me vonesë, kjo mund të ketë pasoja negative në aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. E gjithë korrespondenca juaj do të dërgohet gjithmonë në adresën e fundit të njohur, që do të thotë se nuk do të merrni, ose do t'i merrni me vonesë disa dokumente.

FR | NL



Përcaktimi i gjuhës së procedurës

Gjatë paraqitjes së kërkesës, është e nevojshme të përcaktohet gjuha që do të përdoret gjatë procedurës. Kjo mund të jetë gjuha frënge ose holandeze.

Nëse zotëroni mjaftueshëm frëngjisht ose holandisht, mund të zgjidhni njërën nga këto dy gjuhë si gjuhë të procedurës.

Nëse nuk flisni mjaftueshëm frëngjisht ose holandisht, vetë Zyra e të Huajve përcakton gjuhën e procedurës sipas nevojave të shërbimeve dhe autoriteteve.

Pasi të përcaktohet gjuha e procedurës, ajo mbahet gjatë gjithë procesit, duke përfshirë në CGRA dhe CCE.

Gjuha procedurale ruhet gjithashtu nëse dorëzoni një aplikim të mëvonshëm.



Dhënja e aneksit 26 / 26 quinquies

Kur dorëzoni kërkesën tuaj, OE ju lëshon një aneks 26 (*nëse është kërkesa e parë*) ose një aneks 26 quinquies (*nëse është një kërkesë e mëvonëshme*).

Ky dokument përmban të dhënat tuaja të identitetit, si dhe fotografinë tuaj. Ky dokument përdoret për të vërtetuar se ju keni paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Megjithatë, ai nuk përbën në asnjë mënyrë një dokument identiteti ose shtetësie.



Kujdes :

Nëse nuk i përgjigjeni ftesës për të dorëzuar kërkesën tuaj, ajo përfundon menjëherë. Nga ky moment, ju nuk jeni më kërkues për mbrojtje ndërkombëtare.

Në rast se ju dëshironi të paraqisni kërkesën tuaj në një moment më vonë, atëherë kërkesa juaj do të rihapet.

5. A do të merren parasysh nevojat e mia specifike ?

Gjatë kësaj procedure ju do të dëgjoheni në mënyrë që instancat përkatëse të kenë një pasqyrë të mirë të situatës suaj personale dhe arsyes së kërkesës suaj. Çdo kërkues duhet të ketë të njëjtën mundësi për të rrëfyer historinë e tij sa më mirë dhe në rrethanat më të mira të mundshme, për të mundësuar një vlerësim të saktë të kërkesës.

Një punonjës i OE do të plotësojë një pyetësor me ju për të shqyrtuar nëse duhet të merren parasysh disa aspekte specifike të situatës suaj personale, duke ju dhënë mundësinë për të rrëfyer historinë tuaj sa më mirë dhe në rrethanat më të mira të mundshme. Bazuar në përgjigjet tuaja, punonjësi do të shqyrtojë nëse duhet të sigurohen masa të veçanta mbështetjeje në situatën tuaj specifike.

Është në interesin tuaj të përgjigjeni sa më mirë dhe sa më plotë në pyetjet e punonjësit dhe të paraqisni sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha elementet që dëshmojnë nevojat tuaja eventuale. Kështu, situata juaj personale mund të merret parasysh gjatë procedurës.

Ju keni gjithmonë mundësinë për të komunikuar informacione ose elemente shtesë në një fazë të mëvonshme të procedurës.



6. Dublini?

Fakti që ju jeni në Belgjikë dhe që keni paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë nuk do të thotë automatikisht se edhe Belgjika do ta trajtojë atë.

Ka rregulla në Evropë për të përcaktuar se cili vend është përgjegjës për përpunimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Këto rregulla janë përcaktuar në **Rregulloren e Dublinit**.

Shiko Rregullorën 604/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 qershor 2013 për vendosjen e kriterëve dhe mekanizmave për përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një nga shtetet anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose personi pa shtetësi



Rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore zbatohen nga 31 vende, përfshirë Belgjikën.

Përpara se të mund të shqyrtohen arsyet që ju shtynë të ikni, fillimisht do të jetë e nevojshme të përcaktohet se cili vend – në përputhje me rregullat e Dublinit – duhet të përpunojë kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.



Kur të regjistroni kërkesën tuaj, do të merrni broshurën “Kam aplikuar për azil në Bashkimin Evropian - cili vend do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit tim?” e cila përmban informata më të hollësishme.

Kjo broshurë është e disponueshme në gjuhë të ndryshme dhe figuron gjithashtu në faqen internet të OE:

<https://tinyurl.com/DPIDublinENG>



6.1 KUR ZBATOHEK DUBLINI ?

Rregullorja e Dublinit parashikon disa kritere mbi bazën e të cilave mund të vendoset fillimi i një shqyrtimi për Dublin. Ky ekzaminim bazohet në informacionet e disponueshme, si dokumentet e identitetit, rezultatet e analizave të gjurmëve të gishtërinjve, informatat që instancat belge marrin nga shtetet e tjera anëtare, por edhe në deklaratat tuaja.



Do të merrni broshurën “Unë jam nën Procedurën e Dublinit - çfarë do të thotë? kur të merret vendimi për të filluar një shqyrtim për Dublin për kërkesën tuaj.

Kjo broshurë është e disponueshme në gjuhë të ndryshme dhe figuron gjithashtu në faqen internet të OE :



<https://tinyurl.com/DPIDublinENG>

Nëse nga ekzaminimi del se Belgjika nuk është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës suaj për mbrojtje ndërkombëtare, **një vendim për refuzimin e qëndrimit me urdhër që të largoheni nga territori** do t’ju njoftohet. Në një rast të tillë, do t’ju duhet të shkoni vullnetarisht në shtetin anëtar përgjegjës.

Nëse Belgjika provon se është përgjegjëse për trajtimin e kërkesës suaj, Zyra e të Huajve do ta përcjellë dosjen tuaj – eventualisht pas një seance dëgjimore plotësuese – te CGRA, e cila do të shqyrtojë përmbajtjen e kërkesës suaj.

6.2 A MUND TË TRANSFEROHEM ME FORCË DREJT SHTETIT ANËTARË PËRGJEGJËS?

Po, kjo është e mundur në rrethana të caktuara.

Në këtë rast, ju mund të mbaheni në një vend të caktuar (*qendër të mbyllur*) në mënyrë që të mund të bëhet transferimi në shtetin anëtar përgjegjës.

7. A do të dëgjohem nga oe ?

Çdo kërkues për mbrojtje ndërkombëtare dëgjohet nga Zyra e të Huajve sa më shpejt që të jetë e mundur pas dorëzimit të kërkesës. Seanca mund të zhvillohet në ditën e paraqitjes së kërkesës ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas paraqitjes së kërkesës. Në këtë rast, kërkuesi do të ftohet të paraqitet edhe një herë në OE në një datë të mëvonshme.



sëmundjeje.

Kujdes : nëse nuk mund të jeni të pranishëm në datën e planifikuar, duhet të njoftoni OE sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, arsyet që jepni duhet të jenë të bazuara. Kështu, për shembull, ju duhet të paraqisni një certifikatë mjekësore në rast

Nëse nuk jeni paraqitur në Zyrën e të Huajve brenda 15 ditëve - pas datës së thirrjes, supozohet se nuk dëshironi të vazhdoni më procedurën dhe se keni tërhequr kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Në një rast të tillë, Zyra e të Huajve mund të vendosë t'ju lëshojë një urdhër për t'u larguar nga territori.

7.1 CILI ËSHTË ROLI I BASHKËPUNËTORIT DHE I PËRKTHYESIT ?

Bashkëpunëtori që drejton seancën shpjegon në fillim të saj rolin e tij dhe të përkthyesit.

Nëse keni kërkuar mbështetjen e një përkthyesi kur keni dorëzuar kërkesën tuaj, ky i fundit do të jetë i pranishëm gjatë gjithë seancës.

Roli i përkthyesit kufizohet ekskluzivisht në përkthimin besnik të deklaratave tuaja për punonjës të OE. Përkthyesi nuk mund të ndërhyjë personalisht në dosjen tuaj dhe as të japë mendimin e tij për historinë tuaj. Për më tepër, ai nuk mund të ndikojë në vendimin që merret. Ai duhet të jetë objektiv dhe neutral në çdo kohë dhe të respektojë sekretin profesional.

Nëse në fillim ose gjatë seancës ka probleme komunikimi me përkthyesin (*p.sh. nëse nuk e kuptoni mirë përkthyesin*), duhet ta raportoni këtë menjëherë.

Nëse, për arsye personale që lidhen me arsyet e ikjes tuaj, ju preferoni një punonjës/përkthyes mashkull/femër, kjo duhet gjithashtu të specifikohet sa më shpejt të jetë e mundur. Autoritetet do ta marrin parasysh këtë sa më shumë që të jetë e mundur.

Punonjësi i ngarkuar për zhvillimin e seancës ju informon paraprakisht për qëllimin, rrjedhën e seancës dhe çfarë saktësisht pritët nga ju.

7.2 CILI ËSHTË QËLLIMI I DËGJIMIT ?

Lloji i dëgjimit që do të kryhet varet nga situata juaj personale. Ka disa mundësi:



Dëgjimi në kuadër të procedurës Dublin

Nëse elementet tregojnë se Belgjika nuk është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës, një seancë dëgjimore do të zhvillohet brenda kuadrit të procedurës së Dublinit.

Punonjësi përgjegjës për kryerjen e intervistës së pari mbledh të dhëna për identitetin e kërkuarit, gjendjen e tij civile, përbërjen e familjes së tij, rrugën e tij për në Belgjikë, etj.

Gjithashtu mblidhet informacioni i nevojshëm për të përcaktuar shtetin anëtar përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit.



Dëgjimi për një kërkesë të parë

Kur bëhet fjalë për kërkesë të parë dhe nuk ka asnjë tregues se një shtet tjetër anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës, punonjësi i ngarkuar me seancën dëgjimore fillimisht mbledh informacionin në lidhje me

identitetin, gjendjen civile, përbërjen e familjes, rrugën për në Belgjikë, etj.

Përveç kësaj, punonjësi bashkë me kërkuesin e plotëson pyetsorin e CGRA (ku trajtohen shkurtimisht arsyet e ikjes së kërkuesit) dhe i shënon përgjigjet e kërkuesit.



Ndëgjimi për një kërkesë të mëvonëshme

Në rast se kërkuesi ka kaluar tashmë një procedurë për mbrojtje ndërkombëtare në Belgjikë, punonjësi që udhëheqë seancën dëgjimore nuk i rishqyrton arsyet fillestare të ikjes, por përqendrohet në “elementet e reja” dhe arsyen pse kërkuesi nuk i paraqiti këto elemente më herët. Kërkuesi do të duhet të tregojë pse, duke pasur parasysh këto elemente të reja, ai beson se mund të përfitojë nga statusi i mbrojtjes ndërkombëtare.

7.3 MBYLLJA E DËGJIMIT

Në fund të seancës, deklaratat tuaja lexohen me zë të lartë (*nëse është e nevojshme, me ndihmën e një përkthyesi*). Në këtë fazë, keni ende mundësinë të korigjoni, ndryshoni ose sqaroni disa elemente të caktuara. Më pas ju kërkohet të nënshkruani raportin e dëgjimit. Kështu tregoni se jeni dakord me përmbajtjen e tij.

Megjithatë, nëse refuzoni të nënshkruani për ndonjë arsye, punonjësi e shënon këtë në raportin e intervistës. Punonjësi gjithashtu do të shënon arsyen pse nuk dëshironi të nënshkruani.

7.4 DETYRIMI PËR TË BASHKËPUNUAR

Në fillim të dëgjimit, punonjësi që drejton seancën ju kujton **detyrimin tuaj për të bashkëpunuar**.

Si kërkues, ju keni detyrimin të tregoni të vërtetën në çdo kohë dhe të bashkëpunoni sa më mirë me autoritetet. Është gjithashtu thelbësore

të paraqisni të gjitha dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur për të vërtetuar identitetin tuaj dhe origjinën tuaj (*pra edhe shtetësinë tuaj*), itinerarin tuaj dhe arsyet e ikjes. Prandaj, duhet t'i paraqisni OE-së, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha dokumentet që posedoni (*mundësisht dokumentet origjinale*). Ju gjithashtu duhet të bëni çdo përpjekje për të marrë dokumente mbështetëse, ndoshta duke kërkuar ndihmën e anëtarëve të familjes ose të tjerëve në vendin tuaj të origjinës ose në vende të tjera.

Çdo mungesë bashkëpunimi, deklaratë e rreme ose përpjekje për të mashtruar autoritetet mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e kërkesës suaj.

7.5 SI DO TË ORGANIZOHET DËGJIMI ?

Në parim, dëgjimi zhvillohet gjithmonë personalisht në Zyrën e të Huajve; ku punonjësi, kërkuesi dhe nëse është i nevojshëm edhe përkthyesi do të jenë të pranishëm në të njëjtën dhomë për të zhvilluar bisedën fizikisht.

Megjithatë, OE mund të vendosë të organizojë një seancë dëgjimore në distancë nëse një intervistë në prani fizike rezulton e vështirë, apo edhe e pamundur. Në këtë rast, intervista mund të zhvillohet përmes teknologjisë së videokonferencës ndërmjet palëve të përfshira (*të cilat janë më pas në një vend të veçantë*) duke përdorur një lidhje të sigurt dhe të koduar.

OE siguron gjithmonë që dëgjimi të zhvillohet në mënyrë konfidenciale, d.m.th. në një dhomë të veçantë dhe të mbyllur, pa praninë e palëve të treta, në mënyrë që të jetë në gjendje të garantojë siç duhet konfidencialitetin, pavarësisht nëse seanca zhvillohet personalisht ose në distancë.

Nuk mund të bëhet asnjë regjistrim zanor ose audiovizual i dëgjimit.

Nëse mendoni se në situatën tuaj të veçantë nuk është e përshtatshme të organizohet një dëgjim në distancë, duhet ta njoftoni këtë gjatë regjistrimit të kërkesës suaj dhe të sqaroni arsyen pse në situatën tuaj personale nuk do të ishte e përshtatshme. Një punonjës i OE do të regjistrojë argumentet që keni sjellë dhe do t'i shtojë ato në dosjen tuaj administrative. OE më pas do të shqyrtojë nëse këto kundërshtime janë të justifikuar.

Në këtë drejtim, ai gjithmonë do të marrë parasysh çdo nevojë të veçantë procedurale që mund të keni.

Nëse OE megjithatë konsideron se argumentet tuaja janë të pabaza, do t'ju shpjegojë këtë me gojë. Nëse është e nevojshme, OE do t'i shtojë dosjes suaj administrative arsyet për organizimin e një seance dëgjimore në distancë.

Prandaj do të informoheni me kohë se një seancë dëgjimore po organizohet nga distanca. Ju gjithashtu do të merrni informacionin e nevojshëm në lidhje me rregullimet praktike dhe zhvillimin e dëgjimit.

Me rastin e regjistrimit të kërkesës suaj, do të informoheni në detaje për modalitetet në rast seancës dëgjimore në distancë dhe do të keni mundësinë të formuloni vërejtjet.



Për më shumë informata lidhur me dëgjimin, ju mund të konsultoni faqen e internetit të Zyrës së të Huajve :

<https://tinyurl.com/DPIAuditionENG>



8. Cilat dokumente do ju lëshohen ?

8.1 GJATË PROCEDURËS

Pas dorëzimit të kërkesës, duhet të shkoni në komunën e vendbanimit tuaj kryesor brenda 8 ditëve pune, me ankesin tuaj 26/26quinquies.

Nëse keni dorëzuar një **kërkesë të parë** për mbrojtje ndërkombëtare, Zyra e të Huajve do t'ju japë një *aneks 26*. Administrata komunale e vendbanimit tuaj do t'ju sigurojë, në bazë të këtij dokumenti, një **certifikatë regjistrimi**. Nëse keni dorëzuar një **kërkesë të mëvonshme** për mbrojtje ndërkombëtare, do të merrni një *aneks 26 quinquies*. Ky dokument zgjatet nga Zyra e të Huajve derisa CGRA të ketë marrë një vendim për kërkesën tuaj.

Certifikata e regjistrimit ju lëshohet vetëm nëse CGRA e deklaron kërkesën tuaj të pranueshme. Në këtë rast, aneksi juaj 26 quinquies nuk do të zgjatet më, por ju mund të merrni një certifikatë regjistrimi nga administrata komunale e vendbanimit tuaj.

8.2 PAS DHËNIES SË STATUSIT TË REFUGJATIT

Nëse CGRA ose CCE ua jep statusin e refugjatit, ju do të merrni një certifikatë refugjati. Ju duhet të paraqiteni me këtë vërtetim në administratën komunale të vendbanimit tuaj kryesor. Në bazë të këtij dokumenti, komuna do t'ju regjistrojë në regjistrin e të huajve dhe do t'ju lëshojë një kartë A (*qëndrim të kufizuar*) e vlefshme për 5 vjet.

Pas 5 vitesh nga paraqitja e kërkesës, vini në konsideratë për një qëndrim të përhershëm. Në këtë rast, duhet të paraqisni një kërkesë në komunën e vendbanimit tuaj për të marrë një kartë B. Kjo kërkesë do të shqyrtohet nga Zyra e të Huajve.

8.3 PAS DHËNIES SË STATUSIT TË MBROJTJES PLOTËSUESE

Nëse CGRA ose CCE ju jep statusin e mbrojtjes plotësuese, ju duhet të paraqiteni, me vendim të CGRA-së ose të CCE-së, në administratën komunale të vendbanimit tuaj, e cila do t'ju regjistrojë, në bazë të kësaj certifikate, në regjistrin për të huajt dhe do t'ju lëshojë një kartë A (*qëndrim të kufizuar*) e vlefshme për 1 vit. Karta A mund të zgjatet dy herë nga qeverisja komunale, për një periudhë 2-vjeçare çdo herë, pa udhëzim paraprak nga OE. Kërkesa për vazhdimin e kartës A duhet të dorëzohet 30 deri në 45 ditë para përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së kartës, pranë administratës komunale të vendbanimit.

Pas 5 vitesh nga paraqitja e kërkesës, vini në konsideratë për një qëndrim të përhershëm. Në këtë rast, duhet të paraqisni një kërkesë në komunën e vendbanimit tuaj për të marrë një kartë B. Kjo kërkesë do të shqyrtohet nga OE.

8.4 PAS REFUZIMIT TË KËRKESËS PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Sapo të merret një vendim përfundimtar për kërkesën, OE në parim lëshon një **urdhër për t'u larguar nga territori (OQT)** dhe komuna tërheq (nëse është e aplikueshme) certifikatën e regjistrimit.

Një OQT mund të lëshohet nëse:

- Afati për ankim ndaj vendimit të CGRA ka kaluar dhe nuk është bërë fare ankim.
- CCE-ja mori vendim negativ për ankimin.

Nga një kërkesë e dytë pasuese (= *kërkesa e 3-të*), një OQT mund të lëshohet menjëherë pas një vendimi të papranueshmërisë nga CGRA, nëse ankimi nuk është pezullues.

OQT specifikon brenda cilës periudhë duhet të largoheni nga territori.

Nëse tashmë keni qenë subjekt i një OQT në të kaluarën të cilën nuk e keni zbatuar, OE mund të vendosë të mos lëshojë një OQT të re, por të **riaktivizojë OQT-në e mëparshme**.

Në këtë rast, mund të jepet kohë shtesë për t'u larguar nga territori.

OQT ose riaktivizimi i tij njoftohen drejtpërdrejt në vendbanimin e zgjedhur.

9. A mund të modifikojë të dhënat e identitetit tim ?

Nëse gjatë procedurës vëreni se të dhënat tuaja personale nuk janë të sakta, mund t'i kërkonit OE që t'i korrigjojë ato. Ju mund ta bëni këtë kërkesë gjatë seancës së parë personale; më pas bashkëpunëtori do t'i kalojë të dhënat që ju keni dhënë dhe do t'ju pyesë nëse ato janë të sakta. Këto të dhëna, nëse është e nevojshme, mund të modifikohen.

Megjithatë, nëse dëshironi t'i ndryshoni ato në një fazë të mëvonshme të procedurës ose në një procedurë të mëvonshme, kjo është e mundur vetëm me paraqitjen e një pasaporte të vlefshme ndërkombëtare.

10. Jam i mitur dhe i pa shoqëruar... çfarë duhet të bëj ?

Nëse jeni nën 18 vjeç dhe nuk shoqëroheni nga një prind ose një person që është caktuar në vendin tuaj të origjinës për të ushtruar autoritetin prindëror, do të regjistroheni si i mitur i pashoqëruar. Kjo do të thotë që një bashkëpunëtor i OE, i specializuar për këtë qëllim, do të plotësojë një formular me ju, i cili më pas do t'i dërgohet Shërbimit të Kujdestarisë.

Shërbimi i Kujdestarisë është organi në Belgjikë që do t'ju identifikojë dhe do t'ju caktojë, në këtë rast, një kujdestar.



Ju mund të gjeni më shumë informata lidhur me kompetencat e Shërbimit të Kujdestarisë në faqen e internetit :

<https://tinyurl.com/dpiTutellesFR>



Nëse jeni një kohë më të gjatë në Belgjikë, është e mundur që një organizatë tjetër ju ka regjistruar tashmë në Shërbimin e Kujdestarisë dhe për këtë arsye ju keni tashmë një kujdestar.



Kujdes : Nëse ka dyshime për moshën tuaj, mund të vendoset të kryeni një ekzaminim mjekësor. Kundër vendimit - i cili merret në bazë të rezultatit të ekzaminimit - mund të ankoheni në Këshillin e Shtetit.

Kujdestari juaj do t'ju shoqërojë gjatë procedurës suaj. Kjo do të thotë se ai do të marrë të gjitha ftesat, kërkesat për informacion dhe vendimet që ju përkasin. Prandaj është e nevojshme që kujdestari të jetë i pranishëm në dëgjimin e organizuar në OE. Pa praninë e kujdestarit tuaj, seanca nuk mund të zhvillohet.

Seanca dëgjimore në OE do të zhvillohet nga një punonjës i specializuar për dëgjimin e të miturve. Pyetjet që bëhen gjatë audicionit përshtaten me moshën dhe pjekurinë tuaj.

Kur të regjistroni kërkesën tuaj, do të merrni informacion shtesë.



“UDHËZUES PËR TË MITURIT TË PASHOQËRUAR QË KËRKOJNË AZIL NË BELGJIKE” është gjithashtu i disponueshëm në gjuhë të ndryshme në faqen e internetit të CGRA përmes lidhjes së mëposhtme:

<https://www.cgrs.be/en/publications>



11. A mund të ndihmohem nga një avokat gjatë procedurës ?

Ju mund të ndihmoheni nga një avokat gjatë procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare. Shpenzimet janë përgjegjësia juaj.

Nëse nuk keni mjete të mjaftueshme financiare për të paguar një avokat, mund të kërkonit në çdo kohë një avokat pro deo. Një avokat pro deo është një avokat që ju e zgjidhni vetë ose që emërohet sipas detyrës zyrtare. Ju nuk duhet të paguani avokatin pro deo. Megjithatë, ju duhet të provoni se jeni kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare, për shembull në bazë të aneksit tuaj 26 ose aneksit 26 quinquies.

Si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, ju gjithashtu mund të merrni ndihmë juridike. Kjo ndihmë nënkupton një ulje të kostos së procedurave.

Gjithashtu ekzistojnë edhe shoqata që grupojnë shoqatat të cilat janë të specializuara për ndihmën ndaj të huajve.

UNHCR po mobilizohet për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e të refugjatëve.

Kujdes : nëse më vonë vërtetohet se keni mjetet/të ardhurat e nevojshme financiare, do t'ju duhet të shlyeni të gjithë ose një pjesë të përfitimit që keni marrë nëpërmjet sistemit pro deo.



Ju mund të gjeni më shumë informata lidhur me aktivitetet e UNHCR në faqen e internetit : <https://www.unhcr.org/be>



12. Si të kthehem në vendin tim të origjinës ?

Nëse planifikoni të ktheheni në vendin tuaj të origjinës gjatë ose pas procedurës suaj, gjithmonë mund të përdorni programet e kthimit vullnetar të ofruara nga Fedasil.



Për më shumë informata, ju mund të konsultoni çdo herë faqen internet :

<https://www.voluntaryreturn.be/>



Nëse nuk keni më dokumentet e nevojshme të identitetit për t'u kthyer në vendin tuaj të origjinës, duhet të shkoni në ambasadën e vendit tuaj të origjinës. Mund të merrni përsëri një pasaportë ose leje kalimi atje.

Një përmbledhje e ambasadave dhe të dhënat e



kontaktit të tyre është e disponueshme në faqen e mëposhtme të internetit, nën titullin “ambasadat dhe konsullatat”.

<http://diplomatie.belgium.be>



Për një kthim të menjëhershëm në vendin tuaj të origjinës, ju gjithashtu mund të kontaktoni Njësinë e Kthimit Vullnetar të OE në adresën e mëposhtme të postës elektronike :

return@ibz.fgov.be

13. A mund të mbahem gjatë procedurës ?

Ligji për të huajt parashikon që OE mund të vendosë, në raste të caktuara, t'ju mbajë në një vend të caktuar (*qendër të mbyllur*).

Kërkuesi që mbahet në qendër të mbyllur ka mundësinë të kundërshtojë mbajtjen, në baza mujore, pranë Dhomës së Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë (*seksioni korrektues*), duke paraqitur kërkesë për lirim. Kjo kërkesë duhet të hartohet sipas rregullave të veçanta ligjore.

14. Çfarë bën OE me të dhënat e mia me karakter personal

OE do të sigurojë mbrojtjen e të dhënave tuaja të cilat trajtohen gjatë procedurës, në përputhje me RGPD (*Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave*).

Mund të gjeni më shumë informacion rreth RGPD ose politikës së mbrojtjes së të dhënave të OE [KËTU](#) ose duke skanuar kodin QR të mëposhtëm:



<https://dofi.ibz.be/en/about-us/processing-personal-data/transparency-information-data-subject/transparency-international>

15. Adresat e dobishme



Zyra e të Huajve (OE)
Pacheco
Boulevard Pacheco, 44
1000 Bruxelles

Infodesk
T +32 2 488 80 00

infodesk@dofi.fgov.be
www.dofi.fgov.be
www.ibz.fgov.be



Komisariati i Përgjithshëm i Refugjatëve dhe personave Pashtetësi (CGRA)
Eurostation
Rue Ernest Blerot 39
1070 Bruxelles

T + 32 2 205 51 11

cgra.info@ibz.fgov.be
www.cgra.be



Këshilli Kontestues për të Huajt (CCE)
Laurentide
Rue Gaucheret 92-94
1030 Bruxelles

T + 32 2 791 60 00

info.rvv-cce@ibz.fgov.be
www.rvv-cce.be



Këshilli i Shtetit (CE)
Rue de la Science 33
1040 Bruxelles

T + 32 2 234 96 11

info@raadvst-consetat.be
www.raadvst-consetat.be



Fedasil
Rue des Chartreux 21
1000 Bruxelles

T + 32 2 213 44 11

info@fedasil.be
<https://www.fedasil.be/>



Shërbimi i Kujdestarisë
Boulevard de Waterloo 115
1000 Bruxelles

T + 32 78 15 43 24

tutelles@just.fgov.be
<https://justitie.belgium.be/>



Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR Belgique)
Avenue Louise 283
1050 Bruxelles

T + 32 2 627 59 99

belbr@unhcr.org
<https://www.unhcr.org/be>

Editeur responsable : Freddy Roosemont - Boulevard Pacheco 44, 1000 Bruxelles - BCE 0308.356.862

- Ne pas jeter sur la voie publique -